



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802181/9

Tiranë ___/___/2019

Lënda: *Rekomandohet respektimi i legjislacionit që njeh të drejtën e të paraburgosurve apo të dënuarve për tu njohur me të dhënat personale*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Drejtorit të Përgjithshëm
Z. Agim Ismaili
Tiranë

IEVP KORÇË
Drejtorit
Z. Genci Fejzollari

Të nderuar Zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit në datën 02.11.2018 ka paraqitur ankesë i dënuari Pajtim Abazi, i cili pretendon se që prej datës 21.06.2016 është diagnostikuar nga mjeku specialist me sëmundjen e zemrës, ka marrë mjekim për një vit e gjysmë dhe mjekja ja ka ndërprerë mjekimin me ilaçe pa asnjë arsye. Për këtë arsye i është drejtuar me ankesë mjekes si dhe drejtorisë së IEVP-së, por kjo ankesë nuk është marrë në konsideratë. Po kështu, ai ka kërkuar që t'i vihet në dispozicion kopje e kartelës shëndetësore, por sipas tij as mjekja dhe as drejtori nuk i janë përgjigjur.

Për verifikimin e kësaj ankese kemi bërë kërkesë për shpjegime fillimisht në IEVP Korçë. Në përgjigjen që kemi marrë, me shkresën nr.4443/2 Prot., dt.15.11.2018, përpos informacionit mbi vizitat dhe ekzaminimet e bëra ndaj të dënuarit Pajtim Abazi, ndër të tjera thuhet se, të dënuarve u jepet epikrizë mjeku, por jo kopje karte. Po kështu, i jemi drejtuar me kërkesë për informacion edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që me shkresën Nr.618/1 Prot., dt. 28.01.2019, na bën me dije se, përsa i përket ankesës së të dënuarit mbi vënien në dispozicion të fotokopjes së kartelës mjekësore jo vetëm për këtë të dënuar, por për të gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit, ata duhet të informohen mbi gjëndjen shëndetësore, diagnozën, trajtimin me medikamente, por nuk mund tu vihet në dispozicion kartela mjekësore. Për çdo informacion shëndetësor për të dënuarit apo të paraburgosurit të kërkuar nga institucionet e tjera apo familjarët, do të përgatitet dhe vihet në dispozicion informacion zyrtar nga sektorët e shëndetësisë së IEVP-ve dhe QSB. Fotokopja e kartelës mjekësore i vihet në dispozicion organeve të njohura me ligj, vetëm

kur kërkohet me shpresë zyrtare. Gjithashtu jemi informuar se i dënuari Pajtim Abazi vuan nga probleme të shëndetit mendor, i diagnostikuar me çrregullim deluzional.

Për të shqyrtuar shqetësimin e këtij të dënuari për tu njohur me të dhënat personale, i referohemi akteve normative bazë të cilat rregullojnë të drejtën për informim.

Në Ligjin Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 3, pika 3 parashikohet se:

“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit”

E drejta për informim e pacientit parashikohet edhe në pikën 3 të Kartës të të Drejtave të Pacientit të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë e Shqipërisë më 31.01.2011 ku thuhet se:

“Çdo pacient ka të drejtën për akses ndaj çdo lloj informacioni lidhur me gjendjen e tij shëndetësore, për shërbimet shëndetësore dhe mënyrën e përdorimit të tyre, si dhe për çdo kërkim shkencor apo inovacion teknologjik që mund të jetë i përdorshëm

Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ofruesit dhe profesionistët duhet t’i sigurojnë një informacion të posaçëm pacientit, duke konsideruar në mënyrë të veçantë specifikat fetare, etnike ose gjuhësore të pacientit.....

Një pacient ka të drejtën për tu njohur me dosjen e tij klinike dhe kartelën mjekësore, t’i fotokopjojë ato, të bëjë pyetje mbi përmbajtjen e tyre dhe të marrë korrigjimet e çdo gabimi që mund të ketë në dosje apo kartelë”

Po kështu, në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore¹ neni 25, paragrafi i parë parashikohet se:

“I sëmurit ka të drejtë të informohet për sëmundjen, ekzaminimet dhe mjekimet që i propozohen dhe rezultatet e tyre. Mjeku ka për detyrë ta informojë të sëmurin në mënyrë të sqartë dhe të kuptueshme, duke marrë parasysh në çdo rast personalitetin dhe gjëndjen e tij psikike”.

E drejta e të paraburgosurve apo të dënuarve për tu njohur me të dhënat personale garantohet edhe në nenin 19/4 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve ku thuhet:

“I paraburgosuri apo i dënuari ose një person i autorizuar prej tij, mund t’i kërkojë drejtorit të IEVP-së të njihet me të dhënat personale të tij, pasi i deklaron drejtorit shkaku dhe llojin e informacionit që i duhet. Drejtori i IEVP-së duhet të sigurohet që informacioni i dhënë nuk lidhet me një të paraburgosur apo të dënuar tjetër.”

Pra, po të analizojmë të gjitha aktet e sipërpërmendura, rezulton se njihet e garantohet e drejta e të paraburgosurve apo të dënuarve për tu njohur me të dhënat personale, ku bën pjesë edhe njohja me kartelën mjekësore apo dhe marrja e një kopjeje të saj.

Është e vërtetë, që ekzistojnë disa kufizime ligjore në lidhje me të drejtën për informim, të cilat janë renditur në nenin 17 të Ligjit “Për të drejtën e informimit”. Në pikën 1/a, të nenit 17 parashikohet kufizimi i të drejtës për informim në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton të drejtën për një

¹ Kodit i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore është hartuar nga Këshilli Kombëtarë i Urdhërit të Mjekëve, në zbatim të nenit 4/2/b dhe nenit 20 të Ligjit Nr.123/2014 “Për urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë”.

jetë private; ndërsa në pikën 3 të po këtij neni ky kufizim është i përligjur në qoftë se përhapja e informacionit do të shkelte sekretin profesional të garantuar nga ligji. Po kështu, të dhënat që mëson mjeku rreth të sëmurit, konsiderohen sekret profesional dhe në interes të sëmurit, mjeku mund t'i mbajë të fshehta ato (neni 22 i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore). Por, në shqetësimin e ngritur nga ankuesi, nuk jemi përpara zbatimit të këtyre kufizimeve pasi ai parashtron kërkesë për t'u njohur me të dhënat e veta personale dhe jo të ndonjë personi tjetër.

E drejta e të sëmurit për tu njohur me dokumentacion mjekësor kufizohet nëse mjeku gjykon se, duke e informuar atë rrezikon të dëmtojë gjëndjen e tij psikike dhe shëndetësore (neni 25, paragrafi i tretë i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore). Për rastin e të dënuarit Pajtim Abazi nuk është dhënë ndonjë mendim i mjekut që të përligjë refuzimin për t'i vënë në dispozicion kopje të kartelës mjekësore.

Në përfundim të hetimit administrativ, ne vlerësojmë se kufizimi në përgjithësi i drejtës të të paraburgosurve apo të dënuarve për tu njohur me të dhënat personale, ku përfshihet dhe e drejta për të marrë kopje të kartelës mjekësore nuk është i bazuar si dhe çënon një nga të drejtat e tyre të garantuara me ligj dhe akte të tjera normative.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

REKOMANDOJMË:

- Respektimin e legjislacionit që njeh të drejtën e të paraburgosurve apo të dënuarve për tu njohur me të dhënat personale, ku përfshihet dhe e drejta për tu njohur apo për të marrë kopje të kartelës mjekësore;
- Kufizimin e të drejtës të të paraburgosurve apo të dënuarve për tu njohur me dokumentacionin mjekësor vetëm në ato raste kur mjeku gjykon se dhënia e këtij dokumentacioni mund të dëmtojë gjëndjen e tyre psikike dhe shëndetësore.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Përgatiti: Adil Skuqi, Ndhmëskomisioner

